

Prof. Dr. Lekë SOKOLI

METODAT E KËRKIMIT SHKENCOR

- metodologji • koncepte • përkufizime e klasifikime • strategji e teknika kërkimore • kërkesat etike të kërkimit • sasiore vs. cilësore • intervistimi
- vëzhgimi • anketimi • kampionimi, përfaqësueshmëria e kodimi
- sondazhet e opinionit • metoda krahasuese • eksperimenti • përpunimi dhe analiza e të dhënave kërkimore • ilustrime • shembuj zbatimesh
- një kapitull mbi referencat në kërkimin shkencor etj.



Përmbajtja

Parathënia e botimit të pestë.....	11
------------------------------------	----

PJESA E PARË: ÇËSHTJE METODOLOGJIKE

Kreu I: Metodologjia, një hyrje koncize.....	19
-----------------------------------------------------	-----------

Katër metodat e njohjes sipas Pirs.....	19
Disa teza dhe shtjellime themelore.....	21
Nga se motivohet kërkimi shkencor?	23
Teoria dhe metoda, një shpjegim krahasues	26
“Problemi social” si objekt i kërkimit shkencor.....	28
Hierarkia e problemeve sociale	31
Rregullat e metodës; “fakti social”	33
Metodologjia e studimit të një modeli social dhe domethënia e tij.....	35
Karakteri shkencor i një punimi	38
Objekt i dallueshëm	39
Rishtë, si kusht për një studim shkencor.....	40
Kriteret e botimit në një revistë shkencore.....	42
Shkencat sociale, disa veçori metodologjike	43
Karakteri ndërdisiplinor i një studimi.....	47

Kreu II: Përkufizime, klasifikime dhe shembuj zbatimesh të metodave të kërkimit	49
----------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

Metodat dhe metodologjia	49
Klasifikimi i metodave të kërkimit shkencor	51
Induksioni dhe deduksioni	52
Analiza dhe sinteza	54
Historikja dhe logjikja	54
Normative dhe eksperimentale	56
Metoda dialektike dhe metoda metafizike	56

Metoda sasiore dhe metoda cilësore.....	60
Detyrë: aplikim i metodës cilësore të kërkimit.....	60
Metoda sociometrike.....	63
Procedura sociometrike në një shembull përdorimi.....	65
Kreu III: Etapat e kërkimit shkencor.....	67
E para është ideja.....	67
Ideja fillnisëse; një shembull.....	68
Një studim mbi pedofilinë: motivet e metodologjia.....	70
Nga “temë e ditës” në “temë shkencore”.....	72
Nga ideja te teoria.....	74
Hipoteza, teza dhe antiteza.....	75
Stadet e kërkimit shkencor; Dy hapa përpara, një hap prapa.....	78
Sa stade ka metoda shkencore?.....	80
Kreu IV: Strategjia e kërkimit shkencor.....	81
Hallkat e “zinxhirit kërkimor”.....	81
Problemi i studimit dhe përkufizimi i tij.....	82
Hulumtimi i bibliografisë.....	85
Leximi akademik.....	86
Burimet e para dhe burimet dytësore.....	87
Biblioteka dhe puna me bibliografinë.....	88
Bibliografia & webografia.....	90
Motorët e kërkimit në internet.....	91
Burimet zyrtare.....	92
Kombinimi të burimeve të informimit; Një shembull.....	93
INSTAT.....	95
Arkivat.....	99
Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve.....	101
Një shembull përdorimi të materialeve arkivore.....	102
Kreu V: “Sasiorët” dhe “cilësorët” në debat.....	105
Argumenti I: Objektiviteti i kërkimit shkencor.....	105
Argumenti II: Përgjithësimi.....	108
Argumenti III: Matja & varësitë funksionale midis variabëlve.....	109
Argumenti IV: Qëndrimet e ndryshme në përdorimin e teorisë.....	110
Argumenti V: Fleksibiliteti dhe besueshmëria.....	111
Argumenti VI: Fjalët apo numrat?.....	113
Ajo që nuk është sasiore, a është cilësore?.....	115

Kreu VI: Etika në kërkimin shkencor 117

Ç'është etika?	117
Etika në procesin e njohjes	120
Ligji dhe etika	121
Dilemat etike të kërkimit shkencor.....	126
Kodet etike.....	128
Kërkesat etike të kërkimit.....	130
Kodi i etikës i studentëve & kërkimi shkencor.....	133
Studime të integruara për çështjet më jetësore	135

**PJESA E DYTË: METODAT KONKRETE
TË KËRKIMIT NË SHKENCAT SOCIALE****Kreu VII: Intervista, si metodë e kërkimit shkencor 139**

Një bashkëbisedim njëkahësh	140
Llojet e intervistave	141
Intervistat e standardizuara.....	143
Intervistat e pastandardizuara	145
Intervistat gjysmë të standardizuara	146
Pyetësi i intervistës	146
Disa kërkesa praktike mbi intervistimin.....	147
Intervista, kërkimore apo terapeutike?	148
Fazat e intervistimit	150
Përgatitja	150
Mënyrat e regjistrimit.....	151
Realizimi i intervistimit	153

Kreu VIII: Metoda(t) e vëzhgimit..... 157

“Teleskopi” i studiuesit social	158
Shpirti vëzhgues i Adam Smithit	159
Disa veçori të vëzhgimit si metodë.....	161
Llojet e vëzhgimit kërkimor.....	164
Statet e vëzhgimit kërkimor	166
Vëzhgimi i drejtpërdrejtë	167
Veçanësia vëzhguese e antropologjisë kulturore.....	169
Jeta fisnore shqiptare ndërmjet traditës dhe modernes	170
Vëzhgimi pjesëmarrës: drejtpeshimi midis subjektivitetit dhe objektivitetit	173

Konteksti i ngjarjeve dhe nevoja për studim	175
Të dhëna cilësore nga ditari i studiueses.....	176
Kreu IX: Anketimi si metodë e kërkimit sasior	179
Sondimi dhe anketimi	179
Llojet e anketimit	181
Zinxhiri kërkimor i bazuar në anketimin	182
Hartimi i anketës.....	185
Pyetjet e hapura të anketës.....	186
Pyetjet e mbyllura të anketës	188
Çështje të tjera rreth hartimit të pyetësorëve.....	190
Administrimi i pyetësorëve të anketimeve.....	195
Vlerësime dhe kontestime mbi anketimin.....	197
How to lie with statistics?	199
Kreu X: Kampionimi, përfaqësueshmëria dhe kodimi	203
Censuri i popullsisë dhe i banesave	203
Konceptet bazë rreth kampionimit	206
Përfaqësueshmëria e kampionit të studimit.....	208
Procedura e kampionimit përfaqësues.....	213
Baza e kampionimit.....	213
Kampioni jo-përfaqësues	214
Numri i përbërësve të kampionit të studimit	217
Zgjedhja e njerëzve.....	220
Disa mënyra kampionimi	221
Detyrë studimi " Fëmijët dhe varfëria në Shqipëri"	223
Kodimi.....	224
Talenti dhe të ushtruarit, rregulli i artë i dhjetë mijë orëve.....	226
Kreu XI: Opinioni publik dhe sondazhet rreth tij;	
Saktësia në studimet sociale	229
Demokracia dhe opinioni publik.....	230
Opinioni publik si instrument qeverisës	232
Kaskada e opinioneve	234
Sondazhet e opinionit: Gallup & TNS	236
Saktësia në studimet sociale	237
Gabimi në kampionim	238
Gabimi gjatë anketimit: anketa, anketuesi, i anketuari.....	239

Saktësia e sondazheve elektorale në Shqipëri	241
Kreu XII: Metoda krahasuese	243
Indeksi i zhvillimit njerëzor	243
Studimet krahasuese në epokën e globalizimit	246
Indeksi i demokracisë	246
Indeksi i lirisë ekonomike.....	247
Të tjera indekse krahasuese.....	248
Metoda krahasuese në disa shkenca sociale	249
Metoda krahasuese në sociologji.....	249
Politikat krahasuese	251
Filozofia krahasuese	252
Ekonomia krahasuese	253
Të tjera shkenca sociale krahasuese	254
Metoda krahasuese: Durkheim vs Veber	255
Marin Barleti dhe Kristo Frashëri; një krahasim metodologjik mbi "Historia e Skënderbeut"	258
Kreu XIII: Eksperimenti në shkencat sociale	261
Eksperimenti në disiplina të ndryshme kërkimore	261
Kuptimi i eksperimentit dhe konceptet bazë.....	263
Konsideratat etike të eksperimentit.....	265
Eksperimenti Latané: Prirja për të ndihmuar	266
Eksperimenti në prodhim.....	268
Baza e vendimmarrjes dhe treguesit ekonomikë.....	269
Llojet e eksperimenteve	271
Eksperimenti në psikologji	275
Shembuj nga psikologjia eksperimentale: orientimi i të verbërve.....	277
Harresa dhe intensiteti i veprimtarisë.....	279
Eksperimentet me grupe paralele (shembull)	279
Kreu XIV: Përpunimi i të dhënave kërkimore	285
Përpunimi i të dhënave si hallkë e zinxhirit kërkimor	285
Përpunimi i të dhënave cilësore	286
Përpunimi sasior i të dhënave	288
Metamorfoza e informacionit kërkimor.....	291
Kompjuteri në kërkimin shkencor.....	292
Përpunimi dhe baza e të dhënave.....	294

Paketa statistikore e shkencave sociale (SPSS)	296
Kreu XV: Analiza e të dhënave kërkimore	299
Disa koncepte bazë të analizës kërkimore.....	300
Variablet, llojet e tyre.....	301
Tipi i analizës dhe tabelat e vartësive.....	302
Analiza e bashkëbisedimit.....	304
Analiza e ndodhi-historisë	305
Analiza faktoriale.....	306
Analiza faktoriale e "përvojës shqiptare"	308
Bashkëlidhja midis faktorëve; Matrica Pearson.....	312
Analiza korrelative	314
Vartësia korrelative lineare dhe e kurbëzuar	316
Koeficientët e shoqërimit.....	317
Analiza me regresion.....	319
Lloje të tjera të analizës kërkimore	321
Paraqitja e të dhënave dhe tabelat e rezultateve	322
Hartimi i raportit kërkimor; shkenca vs pseudoshkencës	327
Kreu XVI: Referencat në kërkimin shkencor.....	331
Pse janë të domosdoshme referencat?	331
Sistemet e referencave	332
Referenca, për çfarë?	334
Referencat e librave, periodikëve shkencorë dhe burimeve elektronike	334
A. Për referenca të marra nga librat:	335
B. Për referenca të marra nga revistat (periodikët shkencorë):	337
C. Për burimet elektronike	338
D. Burimet arkivore	339
Citimet dhe referencat në tekst	340
Përputhja e referencave të tekstit me ato të listës së referencave	343
Referencat	349
Një model referencash bibliografike	361

Parathënia e botimit të pestë

A mund të supozojmë një shoqëri në të cilën nuk ekziston metri, peshorja apo instrumentet të tjerë matës...? Sot matet thuhet gjithçka, matet e dukshmja dhe e padukshmja. Deri mendimet, ndjenjat, perceptimet, përfytyrimet, (pa)kënaqësitë, aftësitë, interesat gjithfarëshe, pritshmëritë, zhvillimet e ardhshme, gjithçka. Në librin “Manifesti i Lumturisë” (Marks, 2011), jepen disa strategji që duhet të ndjekë një shtet për të arritur një mirëqenie sa më të lartë për qytetarët e vet. Një ndër to është “krijimi i një sistem që mat gjithçka mund të matet, gjithçka që e bën jetën tonë më të vlefshme e më cilësore, deri ‘bukurinë e poezive tona’ – siç shprehej dikur Xhon Kenedi (1958, cit. Marks, 2011).

Ky libër është pikërisht për një sistem që mat gjithçka, për një metodologji përdorimi të ‘instrumenteve’ matës, për një metodologji kërkimi. Zhvillimi kushtëzohet nga instrumentet matës që përdoren në fushat (shkencat) gjenetike, sociale, teknike-natyrore, të njohës – përgjithësisht.

Ky libër ndihmon për t’u orientuar në fushën e çuditshme të kërkimit shkencor. Por, siç do të shohim, kërkimi nuk është më aq i çuditshëm. Ai lidhet drejtpërdrejt me jetën tonë të përditshme. Madje, vitet e fundit janë shtuar shumë studimet me temë: “Kërkimi shkencor dhe jeta e përditshme”. Në njërin prej tyre, Roberto Dijkgraaf¹ (2016) shkruan se në kohën e sotme “hendeku midis kërkimit dhe jetës së përditshme është duke u ngushtuar në mënyrë shumë të shpejtë, madje nga të dyja anët: shkenca po rend drejt jetës së përditshme dhe, nga ana tjetër, jeta e përditshme po rend drejt shkencës”.

Ne tanimë prekemi nga shkenca në çdo aspekt të jetës. Mjeti më i zakonshëm i ‘transportit’ është bërë interneti i cili lidh gjithkënd dhe gjithçka, thuhet me shpejtësinë e dritës. Telefoni i parë i mençur (Smartphone), për shembull, ka dalë

¹ Roberto Dijkgraaf është drejtor i Institutit për Studime të Avancuara të Universitetit Princeton NJ., SHBA.

në treg vetëm një dekadë më parë. Tani në botë ka më shumë se 2.5 miliardë të tillë dhe dyfish më shumë telefonë të tjerë celularë. Smartphone-t që mbajmë në xhepa kanë më shumë mundësi kompjuterike se superkompjuterët e para pesëmbëdhjetë vjetëve, siç vëren Giddens (2016: 107).

Janë rritur së repërmi edhe kërkesat për njerëz të shkencës, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Vlerësohet se para një shekulli kishte vetëm një mijë shkencëtarë në mbarë globin. Po tani? Vetëm Large Hadron Collider² i ndërtuar në Zvicër kërkon mbi dhjetë mijë shkencëtarë dhe inxhinierë.

Edhe problemet e mëdha sociale, siç janë ato të klimës (ngrohja globale), biodiversiteti, kërkesa për energji, përhapja e sëmundjeve infektive, ato të ekonomisë globale etj., janë bërë më komplekse dhe kërkojnë përgjigje shkencore, domethënë: instrumente matës, baza gjigante të dhënash, institucione dhe qytetarë që kërkojnë e japin zgjidhje. Pra, *të kërkosh do të thotë të kërkosh zgjidhje.*

Në kohën tonë, kërkimi dhe metodologjia e kërkimit nuk janë më pronë e shkencëtarëve. Ato i takojnë çdo profesionisti, pa përjashtim. Kërkimi mundëson që të bëhesh mësues më i mirë, ekonomist më i mirë, sipërmarrës më i mirë, profesionist më i mirë, student më i mirë.

Por kërkimi është, në fakt, gjëja më e natyrshme për çdo qenie njerëzore, falë dy veçorive thelbësore të trurit: aftësisë për të krijuar një baze me të dhëna (njohuri, informacione; database), si dhe aftësisë për t'i përdorur ato, për t'i interpretuar, për të nxjerrë prej tyre përfundime praktike.

Çfarë bëjnë fëmijët, për shembull? Krijojnë bazën e të dhënave dhe zhvillojnë vetveten mbi to, duke pyetur pafundësisht: Pse, si, sa, çfarë, ku, kur? Ata janë të etur për dije, janë gjithnjë të pakënaqur me ato që dinë, janë gjithnjë në kërkim. Ata janë filozofë metodologjikë.

Sot shkolla, duke përfshirë universitet, e ka humbur monopolin e të qenit informuesi i vetëm. Studentët kanë akses informativ aq sa edhe vetë pedagogët e tyre. Ndaj sfida e sotme e shkollimit nuk lidhet me informimin e studentit të painformuar, por me formimin e studentit të informuar. Kjo kushtëzon integrim real të mësimdhënies me kërkimin shkencor, pjesëmarrjen e studentëve në kërkim të drejtpërdrejtë, shndërrimin e raportit pedagog-student në udhëheqës-kërkues. "Metodat e kërkimit" është pikërisht libri i duhur për të ndihmuar në këtë proces formimi.

Ky është një ribotim i përditësuar. Në kushtet kur dijenitë e njerëzimit

² Large Hadron Collider (LHC) është ndërtuar në një tunel me gjatësi 27 km në 175 metër thellësi, nga Organizata Europiane për Kërkime Bërthamore (European Organisation for Nuclear Research, CERN). Ai është kompleksi eksperimental më i madh dhe më i fuqishëm që është ndërtuar ndonjëherë në botë.

dyfishohen në shumë pak kohë, as tekstet universitare nuk mund të kenë jetë-gjatësi. Madje mund të themi se qysh në momentin kur një student diplomohet si specialist në një fushë të caktuar, njohuritë që ai ka fituar në fillojnë të vjetrohen. Të mendojmë, më tej, që studenti i sotëm parashikohet të jetë aktiv në tregun e punës deri në vitet 2060. Pra, dija teorike ka rëndësi, por ajo që bën diferencën është imagjinata. Siç shkruante A. Ajnshtajni “dija është pa fund, ndaj vetëm me imagjinatë mund të pushtohet bota”. Metodologjia është pikërisht ajo që përbën “zemrën” e shkencave, ajo që e orienton profesionistin për zhvillimin e imagjinatës kërkimore, të intuitës profesionale, të intuitës së ekspertëve.³



Të gjithë pohojmë se metodat, krahas teorisë, përbëjnë anën e dytë të medaljes së shkencave. Por, referuar programeve të studimit universitar dhe pasuniversitar, del se *metodat kanë qenë më të pavlerësuarat*. Ndaj vendosja e një ekuilibri midis tyre do ta çojë shumë përpara formimin akademik.

Ky libër është bazuar në programet e reja të studimit në ciklet e ndryshme, kryesisht, të shkencave sociale e humane. Por, libri “Metodat e kërkimit shkencor” nuk kufizohet vetëm në ato metoda kërkimi që janë specifike për këto shkencë. Pavarësisht nuancave, *metodat e kërkimit janë ndërdisiplinore* dhe nuk identifikohen me disiplina të veçanta.

³ E ashtuquajtura “Intuita e ekspertëve” është konsideruar edhe si një ‘shqisë e gjashtë’ e profesionistit. Psikologu Gery Klein tregon historinë e një ekipi zjarrfikësish që hynë në një shtëpi, kuzhina e së cilës po digej. Sapo filluan të shuanin zjarrin komandanti bërtiti “Përjashta!”, pa e kuptuar edhe vetë pse. Dyshemeje u shemb fill pasi ikën zjarrfikësit. Komandanti nuk kishte asnjë ide se çfarë nuk shkonte, por intuitivisht iu krijua përshtypja se diçka nuk shkonte. Doli se epiqendra e zjarrit nuk kishte qenë kuzhina, por bodrumi poshtë dhe zjarri kishte pasur një qetësi të pazakonshme.

Kjo është ‘intuita e ekspertëve’: mjeshtri i shahut kalon para dy vetëve që luajnë dhe pa u ndalur thotë “të bardhët bëjnë mat me tre lëvizje”; mjeku bën një diagnozë komplekse vetëm duke i hedhur një shikim pacientit; sipërmarrësi merr një vendim për investime vetëm duke parë pavionin e një kompanie në një panair biznesi etj. (Kahneman, 2011: 18-19). Të vërtetës (objekt i kërkimit) mund t’i afrosh edhe intuitivisht, apo apriori. Kompetenca intuitive duket si magji, por ajo bazohet në të ushtruarit, përvojën e gjatë, në kërkimin, aftësinë vëzhguese. Studiuasi Herbert Simon ka studiuar, ndër të tjera edhe mjeshtrit e mëdhenj të shahut. Ai (1992), i nervozuar nga mitologjizmi i intuitës së ekspertit, shkruan: “Situata ka dhënë një sinjal. Ky sinjal ia ka bërë të disponueshëm ekspertit informacionin e depozituar në kujtesën e tij. Ky informacion mundëson përgjigjen, përfundimin, marrjen e vendimit. Intuita nuk është gjë tjetër veçse rinjohje. As më shumë, as më pak”. Mjeshtrit e shahut, për shembull, vetëm pas mijëra orësh praktikë arrijnë t’i shohin gurët mbi tavolinë ndryshe nga ne (Simon, 1992). Madje nuk ka ndodhur që një mjeshtrë shahu të bëhet kampion bote pa u ushtruar të paktën për dhjetë mijë orë (Gladwell, 2008).

Në cilësinë e titullarit të lëndës “Metodat e kërkimit shkencor”, e kam përdorur këtë libër si tekst bazë në bachelor e master jo vetëm në degët të ndryshme të shkencave sociale e humane, siç janë *sociologjia, psikologjia, shkencat politike, mësuesie etj.*, por edhe në ato të *drejtësisë, shkencave ekonomie, shkencave të aplikuar* e deri *shkencave mjekësore (farmaci, infermieri)*. Ndaj, ky libër mund të shfrytëzohet si tekst bazë në programe të ndryshme studimi. Mbetet që pedagogët, në përputhje me specifikat e programeve të veçanta, të përzgjedhin nga ky tekst ato pjesë që ata i gjykojnë më të rëndësishme dhe, nga ana tjetër, të hapin paranteza për trajtime të veçanta e literaturë plotësuese.

Ky libër është bazuar në parimin se *metodat e kërkimit shkencor nuk mund të mësohen vetëm përmes librave dhe teksteve, por edhe përmes praktikës kërkimore* dhe e gërshtuar me të. Nga ky këndvështrim, lexuesi i interesuar do të gjejë te ky libër edhe një *udhëzues praktik teknikash kërkimore*, sikurse një mori shembujsh të aplikimit të tyre në fusha të ndryshme e nga autorë të ndryshëm. Nga ana tjetër, i jemi përmbajtur edhe parimit se në shkencë, sikurse në shumë fusha të tjera jetësore, *dhënia e tepruar pas teknikave e kufizon formimin akademik*. Ndaj i është kushtuar vëmendje atyre që përbëjnë shpirtin e shkencës, *trajtimeve teorike* të autorëve më me peshë në jetën akademike.

Falënderoj në mënyrë të veçantë, kolegët e mi pedagogë nga universitetet publike e private në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni për përfshirjen e këtij libri në literaturën bazë të lëndës “Metodat e kërkimit shkencor”, sikurse edhe për vërejtjet, sugjerimet dhe ndihmën tyre.

Pavarësisht “filtrave” akademikë të pedagogëve dhe studentëve, sërish besoj se pasaktësitë dhe gabimet nuk janë shmangur krejtësisht. Ndaj, ripërsëris se vërejtjet tuaja janë të mirëpritura. Madje, ju falënderoj që tani për ato që do të vini në dukje. Me besimin për t’i korrigjuar në botimin e ardhshëm.

I dashur lexues,

Lënda “Metodat e kërkimit shkencor” nuk përfaqëson thjesht një guidë, një instruksion, apo thjesht një manual me rregulla, norma e standarde. Ajo është një *lëndë formuese*. Kjo lidhet sidomos me çështjen: *sa racionalë jemi në sjelljet, në zgjedhjet dhe në veprimet tona?* Jeta jonë është e mbushur me zgjedhje dhe, çdo ditë, na duhet të marrim një mori vendimesh. Por, çfarë ndikon realisht në vendimet që marrim në jetën e përditshme, sa racionalë jemi në qëllimet që i vëmë vetes, sa racionalë jemi në mjetet që zgjedhim për të realizuar qëllimet tona. Sa racional jam unë (ti, ai) si *njeri ekonomik*, si konsumator, apo sipërmarrës? Sa racional jam unë (ti, ai) si *njeri politik*, si votues, apo si i votuar? Sa racional jam unë (ti, ai) si *njeri sociologjik* – si marrës dhe realizues i roleve sociale, në marrëdhënie komplekse me të tjerët?

Racionaliteti lidhet me *përputhshmërinë midis qëllimeve që ndjekim dhe mjeteve që përdorim* për realizimin e tyre. Por, pse ka kaq shumë mospërputhje, pse qeniet njerëzore (individët), grupet sociale, apo edhe shoqëritë (kombet, shtetet) janë kaq irracionale? Pse nuk jemi të saktë edhe kur sjellja jonë nuk udhëhiqet nga keqdashja, budallallëku, apo neglizhenca? Të paktën pse jemi kaq larg modelit natyror, të cilin Shekspiri i famshëm, në gojën e Hamletit të tij, e jep kështu:

Çfarë vepre është njeriu! Sa bujar nga arsyeja! Sa i pakufishëm nga zotësitë! Nga shtati dhe nga lëvizjet sa i hijshëm dhe sa i çuditshëm! Nga veprimi si një engjell! Nga kuptimi si perëndi! Xhevahir i botës! Kurora e gjërave të gjalla!... (Shekspiri, Hamleti, akti i dytë, skena II)

Racionaliteti, rruga drejt perfeksionit, *bazohet në njohjen*, para së gjithash në *njohjen empirike*. Lënda "Metodat e kërkimit shkencor" nuk është vetëm për shkencëtarin, profesionistin e shkencës. Ajo është për joprofesionistin, për profesionistin e ardhshëm. Ajo është për studentin, ndihmon në formimin e tij, ndihmon në racionalizimin e jetës së tij e të tjerëve të lidhur me të.

Le të urojmë, bashkërisht: Udhëtim të këndshëm në rrugën e *kërkimit* e të *formimit*! Ose, udhëtim të mbarë drejt racionalitetit!

Autori, 6 tetor 2016

